



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 67/16
Prishtinë, më 14.9.2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Shqipe Pantina, Bali Muharremi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Jelena Bontić.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti - Ministër i Financave, Enis Spahiu - u.d. Drejtor i Departamentit Ligjor në MF, Ismet Krasniqi - Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit të Kosovës.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Sahit Troshupa nga RTV-21, Fjolla Uka - monitoruese nga KDI, Etleva Moloshi – Asistente, Florina Ejupi-monitoruese nga BIRN, Albulena Nuha Gazetare nga RTV-21, Pranvera Musa- Gazetare nga Kosovapres, Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 1.8.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L- 066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
6. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 1.8.2016

Kryetari - konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejte.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168

Kryetari - Qeveria e Kosovës e ka proceduar në Kuvend për miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës. Çështja kryesore e trajtuara me këtë projektligj janë propozimet për ndryshimet e nevojshme për rritjen e tavanit të investimit të mjeteve të Fondit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si dhe zgjerimi i bazës së instrumenteve tjera të lejuara për investim, në veçanti letrat me vlerë të korporatave ose institucioneve financiare ndërkombëtare, depozita të afatizuara në bankat vendore dhe ndërkombëtare, fonde investive dhe marrëveshje të riblerjes.

Avdullah Hoti - projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të fondit pensional ka për qëllim kryesor rritjen dhe qartësisë të tavanit të lejuar të investimeve të mjeteve të fondit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe qështje tjera menaxheriale që lidhen me fondin pensional. Sipas ligjit në fuqi është përcaktuar shuma e mjeteve që mund të investohen maksimalisht në letra me vlerë brenda një viti, pa e specifikuar për investime të reja apo edhe për riinvestim. Me këtë projektligj rifinancimi nuk definohet si investim i ri. Në anën tjetër projektligji parashih edhe zgjerimin e bazës së instrumenteve të lejuara për investim, në veçanti letrat me vlerë të korporatave apo institucioneve ndërkombëtare financiare, depozitat e afatizuara në bankat ndërkombëtare dhe vendore, për fondin e investimeve dhe marrëveshjen e riblerjes. Projektligji synon të rregulloj edhe disa nene të ligjit bazike lidhur me mandatin dhe bordit, po ashtu rregullon formimin e komitetit të auditimit i cili deri më tani nuk ka qenë i rregulluar me ligj. Në bazë të vlerësimit të ndikimit buxhetor të ministrisë së financave, implementimi i këtij projektligji nuk do të sjell kosto shtesë në institucionet e zbatimit të këtij ligji.

Shqipe Pantina – thekosjë se unë po i bëj disa komente dhe vërejtje nën për nen që me pas parasysht edhe qëndrimin ministrit. Vërejtja e parë është tek titulli i ligjit dhe në këtë aspekt propozim i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka qenë i drejtë, pasi që ajo qfarë rregullon ky ligj është fondi i kursimeve e jo fondi pensional, dhe këto janë dy qështje të ndryshme. Ne po flasim për shtyllën e dytë të kursimeve pensionale, prandaj ndryshimi i titullit duhet të jetë përputhje me përmbajtjen e ligjit. Vërejtja e dytë ka të bëjë me nenin 2 që rregullon qështjen e përbërjes së komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit drejtues të Fondit. Kjo qështje ka qenë e rregulluar qysh me Rregulloren e UNMIK-ut dhe ka mbetur pak a shumë e njëjta formë e zgjedhjes së anëtarëve të bordit. Me këtë projektligj në këtë aspekt ndryshimet nuk janë të mëdha, dhe ndryshimet janë zgjatja e mandatit nga 3 vite në 4 vite të anëtarëve të bordit dhe kompensimi i anëtarit të deleguar nga qeveria. Në këtë drejtim, pyetja ime është a ka konflikt interesi që anëtar i komisionit për përzgjedhje të jetë Guvernatori i BQK-së, kur dihet se trusti është nën menaxhimin e BQK-së? Si dhe përfshirja e Ministrit të Financave në komisionin për përzgjedhje, kur dihet se Ministria e Financave është ajo që emeton letrat me vlerë që blihen nga Fondi dhe kështu që ka hapësirë për konflikt të interesi.

Çështje tjetër është rregullimit të pagesave, ndonëse kjo qështje duhet të rregullohet me ligjin për pagat për zyrtarët e lartë, vërejtja kryesore është kompensimi i anëtarit të qeverisë si anëtar i bordit. Pse duhet të kompensohet anëtar i qeverisë kur ai merr pjesë në takimet e bordit sipas pozitës që ka? Një qështje thelbësore që rregullon ky projektligj është se me këto propozime ju po doni me e rrit shumën e blerjes së bonove të thesarit, e nuk po shpjegohet se ku do të shkojnë mjetet, a do të jenë investime apo thjeshtë

do të shkojnë në buxhet e që do shfrytëzohen për shpenzime të qeverisë. Çështje tjetër thelbësore është propozimi që mjetet e kontribuesve të pa identifikuar në periudhën pas gjashtë vitesh, t'iu merren kontribuesve dhe ti barten qeverisë apo buxhetit të Kosovës, që mendojë se është e padrejtë dhe nuk duhet lejuar. Ne duhet ti bëjmë presion Trustit që bashkë me Administratën Tatimore ti identifikoj se kush janë këta kontribuues pa adresë dhe nëse për ndonjë arsye nuk gjendet se kush janë kontribuuesit, më e drejtë është që kjo shumë t'iu shpërndahet kontribuesve tjerë, se sa t'iu merren nga qeveria. Një vërejtje tjetër është aspekti teknik i hartimit të projektigjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit bazik, ku ne duhet me i shikue edhe tri ligjet tjera që me e pa se qka po ndryshohet dhe mendojë se duhet të adresohet kjo çështje. Këto janë vërejtje fillestare dhe pa u rregulluar këto çështje të ngritura, Lëvizja Vetëvendosje nuk do ta votojë projektligjin, dhe në lexim të parë do të abstenojmë.

Kryetari - sa i përket vërejtjeve teknike për ekzistimin e disa ligjeve në rast të ndryshimeve dhe plotësimeve keni të drejtë pasi që po përballemi me këtë praktikë jo të mirë. I kemi disa ligje, siç është ai i prokurimit dhe financave publike, ku disa herë janë ndryshuar dhe në praktikë i kemi disa ligje të ndara në fuqi dhe do të duhej të ekzistonte një draft i integruar. Kjo çështje duhet të rregullohet me ligjin për aktet normative për të cilin komision përgjegjës është komisioni për legjislacion.

Besa Gaxherri - me vjen mirë që si qeveri keni marrë angazhimin dhe guximin që të ndërhyjmë në ligjin për fondin e kursimeve pensionale. Ne gjithmonë kemi bërë vërejtje që me rrit huamarrjen e investimeve në Kosovë dhe duhet të angazhohemi të gjithë që të nxjerrim një ligj qfarë na nevojitet. Mendoj se përveç rritjes së tavanit, kemi mundësi edhe në shumën rritjes së investimeve të organeve tona. Kemi nevojë, por kemi edhe siguri bankare dhe i kemi të gjitha mundësitë dhe jam shumë bindur që ka programe të caktuara e sidomos tek kapitale që ketë më shumë investime në Kosovë. Ndërsa për vërejtjen teknike të ekzistimit të disa ligjeve pajtohem me ju. Por edhe materialet për ligjet që vijnë nga qeveria e që na fotokopjohen shpesh janë të pa lexueshme dhe këto probleme duhet ti përcjellim tek kryetari apo tek kryesia që materialet të fotokopjohen si duhet dhe të lexueshme.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se rregullat apo praktikat e Kuvendit janë pak problematike në rastin e amendamentimit të plotësimit dhe ndryshimit të ligjeve. Ne tani mund të ndërhyjmë vetëm në këto nene që ka bërë ndryshime qeveria dhe jo në nenet tjera të ligjit bazik, që unë konsideroj që nuk është diçka e mirë sepse është dashtë të gjejmë një zgjidhje që me pas mundësi me ndërhy edhe në nenet tjera të ligjit që aty ku e shohim me të arsyeshme me ba ndryshime, që ligji të bëhet më i mirë. Në rastin konkret unë kam një shqetësim rreth mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve të kontribuesve pensional që shkojnë në fondin pensional dhe se si ata më tutje ti shfrytëzojnë këto mjete apo për mënyrën e kthimit të këtyre mjeteve tek personat të cilat i kanë kursyer këto mjete. Por kam një pyetje për ministrin, tek deklarata e përputhshmërisë së projektligjit me legjislacionin e BE-së e përgaditur nga Ministria e Integrimeve Evropiane, thuhet se ky projektligj duhet të harmonizohet me legjislacionin dhe praktikat me të mira të BE-së, veçanarisht duke marrë për bazë edhe kërkesat që dalin nga MSA në këtë fushë. Pse është vlerësim i tillë dhe sa është i harmonizuara ky projektligj me ligjet e bashkimit evropian?

Avdullah Hoti - lidhur me titullin e ligjit është komenti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ne e përkrahim dhe sugjerojmë të bëhet ky ndryshim. Lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të bordit drejtues të Fondit Pensional, komisioni për përgjedhje i zhvillon procedurat dhe vetëm propozon listën dhe është Kuvendi që e përzgjedh anëtarët e bordit, që po ashtu i japin përgjegjësi Kuvendit. Lidhur me kompensimin e anëtarëve të bordit që emërohet kjo nuk hynë në listën e pagave sepse Trusti është i pavarur e jashtë sistemi buxhetor. Se ku shkojnë mjetet që trusti i investon letrat me vlerë prapë është buxheti vjetor që përfshin projektet kapitale e shpenzimet tjera që ju i miratoni si Kuvend. Me ligj është rregulluar kufiri i deficitit buxhetor dhe që është 2% e GDP-së për të mos lejuar thellimin e borgjit publik dhe mjetet që do të merren nga letrat me vlerë sigurohen me buxhet të rregullt ku shpenzohen korrekt. Çështja tjetër e mjeteve të pa adresë është ne jemi bazuar ne parime në fusha tjera se pas gjashtë viteve çdo borgj vjetërsohet dhe mjetet që janë në Trustin Pensional e që nuk janë të

identifikuara në llogari përkatëse ato mjete me vendim të bordit mund drejtpërdrejtë të shkojnë në buxhet të shtetit dhe qeveria merr për obligim që kur do që të indifikohen kontribuesit ato mjete kthehen në llogari të tyre.

Enis Spahiu – vitin e kaluar Qeveria ka miratuar një koncept dokument për përmirësimin e ambientit të huamarrjes në republikën e Kosovës dhe komform këtij dokumenti kemi përgaditur propozimet për ndryshimet dhe plotësimet ligjore, që kanë të bëjnë me huamarrjen dhe disa qëshje tjera që ka të bëjë me menaxhementin dhe ne nuk jemi futur në ndërhyrje tjera esenciale. Sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, së fundi kemi një direktivë që rregullon fushën e pensioneve në nivel të BE-së, por qëshjtje që janë rregulluar me këtë projektligj nuk janë të mbuluar me legjislacionin e BE-së. Si tërësi janë disa pjesë në fushën pensionale që duhet harmonizuar me legjislacionin e BE-së dhe na mbetet në të ardhme që kurdo që propozohen ndryshimet e reja të bëhet harmonizimi me legjislacionin e BE-së.

Shqipe Pantina - ju po thoni se e kemi rregulluar vetëm qëshjtjen e huamarrjes. Por ju lutem na tregoni se neni 2 qfarë ka të bëjë me huamarrjen apo me mandatin e menaxhentit? Sa i përket komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit, në këtë formë qysh është e rregulluara po ngushtohet hapësira e Kuvendit. Unë jam dakord që këto tri institucione të përfshihen në proces, qoftë përmes hartimit të kriterëve apo dhënies së këshillave profesionale, por jo të bëjnë drejtpërdrejtë përzgjedhjen e emërave.

Kryetari - i vetmi organ që e mbikqyrë Fondin është Kuvendi i Kosovës. Propozojë që të përkrahim në parim projektligjin dhe ti rekomandojmë Kuvendit që të miratojë në parim projektligjin.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni me nëntë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligji nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L- 066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Kryetari – komisioni në mbledhjen e kaluar ka shqyrtuar këtë projektligj i cili vlerësohet se ka kosto buxhetore shtesë buxhetore rreth 2,990,220 euro dhe atë 771,940 euro për vitin 2016, 63,940 euro për vitin 2017 dhe 663,940 euro për vitin 2018, dhe kemi kërkuar prej Ministrisë së Financave të na jepin informata më detale për koston buxhetore, kur dihet se projektligji është proceduar vitin e kaluar në Kuvend. Nenet të cilat vlerësohen se kanë kosto shtes janë neni 8 që ka të bëjë me krijimin e Këshillit shtetëror për profesionet e rregulluara. Neni 9 lidhur me themelimin e Agjencisë së Kosovës për standarde dhe vlerësim dhe paragrafi 4 i nenit 12 ku është rregulluar qëshjtje e kompensimit të praktikanëve, dhe me amendamentin 12 është specifikuar që pagesa të jetë jo më pak se 50% e pagës së të punësuarëve.

Avdullah Hoti - kjo kosto shtesë e vlerësuar nuk është e përfshirë brenda buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e ne veçanti në vitin 2017 e kemi shumë të vështirë me u rrit kjo buxheti për këtë kosto.

Safete Hadërgjonaj – ajo që për mua ka qenë shqetësuese gjatë gjithë kohës apo mandateve në Kuvendin e Kosovës dhe si anëtare e komisionit për buxhet ka qenë se projektligjet po na vijnë në komision të pa harmonizuara në Qeveri, sa i përket kostos buxhetore. Këtë çështje e kemi ngritur disa herë e kemi thënë se kur ka kosto buxhetore dhe nuk është e paraparë në buxhetin vjetor dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, nuk duhet proceduruar ligji në Kuvend, pa u harmonizuar qëndrimet në qeveri. Mirëpo lidhur me këtë projektligj, shifet kostoja buxhetore që nuk është pa përballueshme për buxhetin. Prandaj, kishte qenë mirë me qenë prezent edhe Ministri i Arsimit e të diskutojmë, nëse ai ka ndonjë premtim edhe nga organizata apo donatorët tjerë për këtë qëllim. Pra, aktualisht nuk i kemi informatat e mjaftueshme, dhe është mirë për me e shty deri në javën e ardhshme e të konsultohemi me Ministrin e Arsimit e ta marrim një mendim nga ai.

Kryetari - propozojë që shqyrtimi i projektligjit dhe amendamenteve të shtyhet për dy javë, dhe në të njëjtën kohë të formojnë grup punues, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadërgjonaj dhe Enver Hoti. Në takimin e grupit punues do të ftohen përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- I. Themelohet Grupi Punues i Komisionit për shqyrtimin e Projektligjit nr.05/L- 066 për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport në aspektin e ndikimit buxhetor, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadërgjonaj dhe Enver Hoti.
- II. Grupi Punues përgadit raportin me rekoandime për shqyrtim në Komision.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetari - vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet amendamenteve të propozuara nga komisioni për funksional, pasi që me këto amendamente ndryshon organizimi dhe struktura e shërbimit mjekësor e emergjent dhe po ashtu ndryshohet koncepti nga drafti që ka sjell Qeveria me projektligj.

Avdullah Hoti – në vlerësimin e parë buxhetor prej Ministrisë së Financave në këtë projektligj janë disa nene që kanë një kosto të vogël dhe të përballueshme dhe bëhet fjale për 15,500 euro. Amendamentet e komisionit funksional kanë dal jashtë asaj që është punuar në draft ligjin për shërbimet emergjente dhe këto amendamente kanë implikime të mëdha buxhetore. Ky draft ligj të kthehet edhe një herë në Ministrinë e Financave dhe të bëhet një vlerësim buxhetor se a është e përballueshme kjo kosto buxhetore.

Safete Hadërgjonaj - ne po mundohemi shumë gjëra të rregullojmë me ligje që kanë kosto buxhetore, dhe pastaj po marrim vërejtje nga Bashkimi Evropian, për këto ligje që po bëhen të pa zbatueshme. Megjithatë, mendojë që ne edhe me këtë projektligj duhet me punë më tutje sepse nuk mundemi t'i'u themi jo të gjitha këtyre amendamenteve, por mirë është të koordinohemi dhe të bëjmë një grup punues dhe të gjejmë një zgjidhje.

Fikrim Damka – ne si komision funksional kemi pasur një takim me ministrin e shëndetësisë dhe kryeministrin dhe kemi marr pëlqimin prej dy palëve për këto ndryshime të bëra përmes amendamenteve.

Avdullah Hoti – amendamentet e propozuara janë jashtë asaj që ka sjell Qeveria dhe këto amendamente kanë implikime buxhetore, të cilat janë pa përballueshme për buxhetin e Kosovës për tri vitet e ardhshme.

Kryetari - propozoj që me e themelue një grup punues që në afatin dy javor të shqyrtojë projektligjin dhe amendamentet e komisionit funksional, me mbështjeten e ministrisë së financave dhe ministrisë së shëndetësisë, dhe të paraqet raportin me rekomandime për komisionin. Propozojë anëtar të grupit punues të jenë: Bali Muharremaj (kryesues), Labinotë Demi – Murtezi, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- I. Themelohet Grupi Punues i Komisionit për shqyrtimin e Projektligjit nr.05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në aspektin e ndikimit buxhetor, me këtë përbërje: Bali Muharremaj (kryesues), Labiontë Demi-Murtezi, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.
- II. Grupi Punues përgadit raportin me rekoandime për shqyrtim në Komision.

6. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016

Kryetari – Administrata e Kuvendit ka përgaditur dhe ka dorëzuar me kohë raportin gjashtëmujor të shpenzimeve të Kuvendit.

Ismet Krasniqi – sqaroi se në gjashtëmujorin e parë, shpenzimet e Kuvendit të Kosovës sipas kategorive ekonomike janë: për paga dhe mëditje janë 44.01%, mallra e shërbime 44.81%, shpenzimet komunale 39,53%, subvencione dhe transfere diku 92%, ndërsa investimet kapitale 25.96%. Kategoritë e lartpërmendura me përjashtim të shpenzimeve kapitale janë rrjedhë dinamike e paraparë me planin e shpenzimeve. Sa i përket shpenzimeve kapitale në muajin korrik dhe gusht kanë ndodhur disa aktivitete të cilat janë në fazën përfundimtare. Sa i përket projektit për ndërrimin e paisjeve të IT-së në sallën plenare është vështirë i zbatueshme dhe kemi kërkuar që nga ky projekt të ndahet një shumë për një projekt për studim fizibiliteti, se qfarë paisje do të përzgjidhen që janë kompatible për atë sallë dhe në vitin 2017 të shkojmë projekt të ri.

Shiqipe Pantina - vërejtja ime është tek tek kabineti i kryetarit, sidomos tek shpenzimet për udhëtimet zyrtare dhe stafi dhe të njëjtën vërejtje e kam pas edhe me rastin e diskutimit të rishikimit të buxhetit. Në këtë drejtim, si vërejtja e përgjithshme është se kabineti i kryetari është i mbingarkuar me staf, paga dhe udhëtime zyrtare dhe ne si Kuvend duhet me pas parasysh faktin që në këtë aspekt t'ia shkurtojmë buxhetin. Vërejtja tjetër ka të bëjë me mosshpenzimin e buxhetit të komisioneve në gjashtëmujorin e parë. Ndonëse shumat janë të vogla, mjete nuk kanë janë dhënë për ndihmë profesionale, por për kafe, dreka dhe darka. Unë mendojë se më mirë kishte me qenë që të investohet më shumë në staf, t'iu mundësohet stafit mbështetës me trajnime dhe në ngritje të kapaciteteve e jo të angazhohen ekspert të jashtëm sepse kjo është më e qëndrueshme. Nuk e di si doni me shpenzue kursimet e bëra nga opozita por mospjesëmarrje në takime dhe seanca.

Enver Hoti – theksoi se nga të dhënat e prezantuara, po shoh se diferenca këtij gjashtëmujori me gjashtëmujorin e kaluar për shpenzime tjera të udhëtime jashtë vendit është dikun për rreth 16,000 euro , qfarë është kjo dhe pse ka ndodhur? Mandej, tek shpenzimet për pagesën e biletave për udhëtimet jashtë vendit është një diferencë e madhe e shpenzimeve krahasuar me vitin e kaluar dhe në duke ditur edhe

mungesën e opozitës, a keni organizuar ndonjë ekskurzion apo për qfarë kanë ndodhur këto shpenzime? Po ashtu pyeti sekretarin e Kuvendit pse ende nuk po gjindet hapësira për punë në Kuvend për ish Kryetarin e Kuvendit, sipas obligimeve ligjore që kërkojnë?

Ismet Krasniqi - shpenzimet janë pasqyruar në detale për të gjitha aktivitetet që kanë ndodhur. Çdo shpenzim është i mbuluar me ndonjë vendim. Ne si administratë jemi të obliguar të zbatojmë vendimet që merren dhe nuk jemi përgjegjës më i komentuar përmbajtjen e tyre, se për qfarë janë destinuar shpenzimet. Sa i përket pyetjes për krijimin e hapësirës për punë për ish kryetarin e Kuvendit, njoftoi se çdo gjë është gati.

Kryetari – propozoi miratimin e Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2016.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni me katër vota Për, tre Abstenime dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2016.

7. Të ndryshme

Kryetari – propozoi që të themelohet një grup punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndihmën shtetërore.

Në bazë të propozimit të kryetarit, Komisioni themeloi grupin punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndihmën shtetërore, me këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Safete Hadërgjonaj, Shipe Pantina dhe Fikrim Damka.

Shukri Buja - pyeti se a ka ardhur ndonjë kërkesë nga RTK-ja, e cila është dërguar edhe në qeveri dhe ndërlihet me pranimin e Kosovës në FIFA dhe obligimet për transmetimin e ndeshjeve të Kosovës. Kërkesa është për 400,000 euro të cilat nuk ka mundur të planifikohen për shkak të pranimin me vonesë të Kosovës në FIFA.

Kryetari - kërkesa e RTK-së nuk ka ardhur në komision por iu është drejtuar Kryetarit të Kuvendit dhe qeverisë.

Bardhyl Meta – theksoi se e vlerëson të nevojshme që komisioni të organizojë një workshop dhe të bëjmë një vlerësim të punës së komisionit. Të mos të merremi me shqyrtimin e raporteve financiare të pa audituara dhe në vend të saj të merret me disa tema që janë të rëndësishme, siç rasti i gjendjes financiare të Postës dhe Valës, për gjendjen financiare të ndërmarrjave publike, qështjen e pagesës së qirasë që paguan qeveria për institucionet shtetërore. Janë këto tema të rëndësishme për diskutime, për të cilat duhet të bëjmë analiza dhe të nxjerrim rekomandime konkrete.

Mbledhja përfundoi në ora 12:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani